# Pjesëmarrja e të Rinjve

# në Zgjedhje

# në Kosovë

**Korrik 2016**

Pjesëmarrja e të Rinjve në Zgjedhje në Kosovë

Të drejtat e autorit© 2016 Fondacioni Ndërkombëtar për Sisteme Zgjedhore.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Deklaratë e lejes: Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet në asnjë formë ose në asnjë mënyrë, elektronike ose mekanike, përfshirë fotokopjimin, regjistrimin apo me ndonjë sistem për rruajtje dhe nxjerrje të informatave pa lejen me shkrim të IFES-it.

Në kërkesat për leje duhet të përfshihen informatat e mëposhtme:

- Përshkrimi i materialit për të cilën dëshirohet leja për kopjim.
- Qëllimin për të cilin do të përdoret materiali i kopjuar dhe mënyra në të cilën do të përdoret.
- Emri juaj, titulli, emri i kompanisë apo organizatës, numri i telefonit, numri i faksit, e-mail adresa dhe adresa e postës

Ju lutem dërgoni të gjitha kërkesat për leje t'i dërgoni në:

International Foundation for Electoral Systems
2011 Crystal Drive, Floor 10
Arlington, VA 22202
E-mail: editor@ifes.org
Fax: 202-350-6701

Ky raport është mundësuar nga përkrahja bujare e popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Opinionet e shprehura në këtë raport janë të autorit(ëve) dhe jo domosdoshmërisht i pasqyrojnë pikëpamjet e USAID-it apo Qeverisë së Shteteve të Bashkuara.

## Përmbajtja

A. Përmbledhje Ekzekutive ........ 4

B. Hyrje ........ 5

C. Metodologjia ........ 6

D. Gjetjet nga fokus grupet ........ 7

1. Arsyet për të votuar ........ 7
2. Arsyet për të mos votuar ........ 9

E. Përmbledhje e statistikave mbi pjesëmarrjen në votime ........ 13

F. Pjesëmarrja e votuesve në katër zgjedhjet e fundit, sipas grupmoshave dhe komunave ........ 14

G. Trendet e pjesëmarrjes në votime për secilën komunë, sipas grupmoshave dhe gjinisë ........ 35

# A. Përmbledhje Ekzekutive

Raporti *Pjesëmarrja e të Rinjve në Zgjedhje në Kosovë* përfshin një vlerësim lidhur me arsyet pse të rinjtë në Kosovë votojnë apo nuk votojnë në zgjedhje, dhe paraqet të dhëna mbi pjesëmarrjen e votuesve në katër zgjedhjet e kaluara të ndara sipas grupmoshave, komunave dhe gjinisë. Gjetjet e paraqitura në këtë raport bazohen në diskutimet nga dhjetë fokus grupet e mbajtura me të rinjtë, dhe të dhënat statistikore të mbledhura në vendvotime në bazë të asaj se kush ka votuar në Ditën e Zgjedhjeve.

Arsyet kryesore përse shumica dërmuese e pjesëmarrësve në fokus grupe ishin të motivuar për të votuar ishin: për të bërë ndryshime në politikë dhe qeverisje, për të përmbushur detyrën e tyre qytetare dhe obligimin moral, për të siguruar përfitime personale si shpërblim, për t'i penguar të tjerët nga keqpërdorimi i votës së tyre, për të ushtruar të drejtën e votimit për herë të parë dhe për të votuar si kundërpërgjigje ndaj presioneve politike dhe shoqërore.

Një numër i vogël i pjesëmarrësve në fokus grupe theksuan se nuk kishin votuar, apo që nuk do votonin në të ardhmen. Sipas tyre, disa nga arsyet përse ata, apo votues të tjerë nuk votojnë janë: votimi nuk sjellë ndonjë ndryshim, perceptimi i korrupsionit politik, zhgënjimi me proceset politike, perceptimi i mashtrimeve zgjedhore, nuk ka kandidatë apo subjekte politike për të përkrahur, zhgënjim pas votimit për herë të parë, si dhe pengesa tjera teknike të ndërlidhura me përfshirjen e votuesve në listat e votuesve në zonat e minoriteteve.

Të dhënat statistikore tregojnë se në katër zgjedhjet e zhvilluara që nga viti 2009 deri më 2014, pjesëmarrja e të rinjve (18 deri në 29 vjeç) ka qenë ose më e lartë (në 2014, 2013, 2010) ose e barabartë me (në 2009) pjesëmarrjen e përgjithshme të votuesve. Në katër komunat veriore, Zveçan, Leposaviq, Mitrovicë Veriore dh Zubin Potok, pjesëmarrja mesatare e votuesve të rinj në katër zgjedhjet e kaluara ishte shumë e ulët, gjë që u ndikua para vitit 2013 nga çështjet e bojkotimit dhe qasjes në zgjedhje. Përveç këtyre katër komunave, mesatarja më e ulët e pjesëmarrjes së votuesve të rinj gjatë katër zgjedhjeve të fundit ishte paraqitur në komunat e Dragashit, Deçanit, Prizrenit, Mitrovicës, Gjakovës, Junikut, Rahovecit dhe Pejës, ku në këto komuna pjesëmarrja mesatare ishte në mes 36 dhe 41 përqind.

Pjesëmarrja e votuesve është më e larta në mesin e të rinjve 18 deri 21 vjeç, në krahasim me të gjitha grupmoshat tjera në të gjitha katër zgjedhjet e fundit. Në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014, pjesëmarrja e të rinjve 18 deri 21 vjeç ishte më e lartë sesa pjesëmarrja e përgjithshme e votueseve në pothuajse të gjitha (36 nga 38) komunat. Gjetjet përputhen me pikëpamjet e disa pjesëmarrësve në fokus grupe të cilët ishin të motivuar për të votuar në zgjedhje duke qenë të entuziazmuar për të votuar për herë të parë.

Pjesëmarrja në votime ulet në mënyrë progresive tek të rinjët e moshave 22 deri në 25 dhe nga 26 deri në 29. Në katër zgjedhjet e fundit, pjesëmarrja e të rinjve prej 26 deri në 29 vjeç është nën mesataren e pjesëmarrjes së përgjithshme të votuesve. Në përgjithësi, pjesëmarrja në katër zgjedhjet e kaluara e të rinjve është më e ulët tek femrat e moshës 26-29 vjeçare. Kjo gjetje mbështetet edhe nga pikëpamjet e disa pjesëmarrësve në fokus grupe të cilët u shprehen se ishin të zhgënjyer pasi që kishin votuar për herë të parë në zgjedhje.

Pjesëmarrja e femrave nga 18 deri në 29 vjeçare është ngritur dukshëm nga zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2010 deri tek zgjedhjet lokale të vitit 2013. Në përgjithësi, përqindjet e pjesëmarrjes tregojnë se gati në çdo komunë dhe në mesin e të rinjve nga të gjitha grupmoshat, kishte pjesëmarrje më të lartë të femrave sesa të meshkujve në zgjedhjet lokale të vitit 2013. Për dallim nga kjo, pjesëmarrja ishte me e madhe në mesin e të rinjve meshkuj sesa tek femrat e reja në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014. Megjithatë, pjesëmarrësit meshkuj dhe femra në fokus grupe ishin në përgjithësi të mendimit se votimi në zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale është i rëndësisë së njëjtë. Të vetmit tregues nga fokus grupet lidhur me arsyet përse femrat votuan në proporcion më të madh në zgjedhjet lokale të vitit 2013 ishin pikëpamjet se autoritetet komunale ndikojnë më drejtpërdrejtë tek jeta e përditshme e femrave, dhe se femrat mund të njohin kandidatët e zgjedhjeve lokale.

## B. Hyrje

Pjesëmarrja e votuesve definohet si përqindja e atyre votuesve të cilët kanë qenë në listën e votuesve në zgjedhje të cilët në fakt kanë votuar në ato zgjedhje. Këto të dhëna për katër zgjedhjet e kaluara në Kosovë (2009 lokale, 2010 të përgjithshme, 2013 lokale, dhe 2014 të përgjithshme), të cilat mund të zbërthehen sipas gjinisë, grupmoshave dhe komunave mbahen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ). Një vlerësim preliminar i të dhënave zbuloi trende interesante të pjesëmarrjes, në veçanti tek votuesit e rinj dhe femrat. Për t'i kuptuar më mirë këto trende të pjesëmarrjes të të rinjve, IFES zhvilloi dhjetë fokus grupe në komuna të ndryshme të Kosovës me të rinj në mes 18 dhe 29 vjeç, kryesisht për t'i gjetur arsyet përse ata votojnë, apo nuk votojnë në zgjedhje.

Ky raport paraqet një kombinim të gjetjeve nga fokus grupet dhe të dhënave statistikore mbi pjesëmarrjen e votuesve të rinj. Kapitulli D i raportit përshkruan arsyet përse të rinjtë votojnë apo nuk votojnë në zgjedhje. Kapitulli F paraqet figurat mbi pjesëmarrjen e votuesve për katër zgjedhjet e kaluara, të ndara në grupmosha (të gjithë votuesit; dhe ata prej 18 deri në 29, 18 deri në 21, 22 deri në 25, dhe 26 deri në 29 vjeçar) dhe në komuna, për të mundësuar krahasimin në mes komunave dhe grupmoshave të pjesëmarrësve në këto zgjedhje. Kapitulli G i raportit paraqet figurat e trendeve të pjesëmarrjes së votuesve në nivel të Kosovës dhe secilën komunë në veçanti, për meshkuj, femra dhe të gjithë votuesit nga të gjitha grupmoshat e lartëpërmendura në katër zgjedhjeve të fundit.

Informatat e paraqitura në këtë raport do të jenë të dobishme për KQZ dhe për organizatat e shoqërisë civile gjatë zhvillimit të strategjive të tyre për edukim të votuesve, në veçanti për identifikimin e grupeve të votuesve të rinj për të cilët kërkohet një mënyrë më efektive e targetimit dhe motivimit. Raporti gjithashtu i informon subjektet politike mbi grupmoshat e të rinjve dhe zonat, në cilat ata mund t'i përqendrojnë fushatat e tyre zgjedhore për të mobilizuar më shumë përkrahje zgjedhore.

Ky raport është përgatitur nga studentë[1] të nivelit bachelor të angazhuar në punë praktike hulumtuese, si pjesë e programit të IFES në Kosovë, të financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), 'Rritja e Përfshirjes dhe Zvogëlimi i Dhunës në Proceset Elektorale', nën udhëheqjen e stafit të IFES në Kosovë. Ky raport është njeri nga

[1] Eugen Cakolli (Fakulteti i Shkencave Politike, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"), dhe Majlinda Jashanica (Fakulteti i Sociologjisë, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"). Kontribut në analizën kualitative është dhënë gjithashtu nga Rrita Rugova (Rochester Institute of Technology Kosovë).

tri raportet mbi hulumtimet e çështjeve të pjesëmarrjes së rinisë në Kosovë të përgatitura nga IFES në vitin 2016. Dy raportet tjera paraqesin gjetjet mbi rolin e rinisë në subjektet politike, dhe ndikimi i gjuhës së urrejtjes në politikë mbi rininë e Kosovës.

## C. Metodologjia

Ky raport paraqet një kombinim të gjetjeve nga fokus grupet dhe të dhënat statistikore mbi pjesëmarrjen e votuesve të rinj. Gjetjet e paraqitura në Kapitullin D bazohen në diskutimet nga dhjetë fokus grupet e zhvilluara në komuna të ndryshme të Kosovës me të rinjtë e moshës nga 18 deri në 29 vjeç. Kjo grupmoshë përdoret në definicionin e rinisë nga USAID. Pjesëmarrësit e fokus grupeve janë përzgjedhur përmes teknikës së rastësishme "snow-ball", dhe gjatë përzgjedhjes është siguruar që të ketë përfaqësim të një spektri të gjerë të rinisë me prapavija të ndryshme socio-ekonomike dhe nivele të angazhimit shoqëror, si dhe të vendbanimeve rurale dhe urbane. Në përgjithësi, grupet ishin të balancuara nga aspekti i gjinisë dhe përfshinin persona me aftësi të kufizuara dhe përfaqësues të komuniteteve minoritare. Dy nga dhjetë fokus grupe janë zhvilluar me minoritetet Serbe në Graçanicë dhe Mitrovicë Veriore. Një fokus grup është zhvilluar vetëm me pjesëmarrëse femra në Ferizaj dhe një tjetër fokus grup është zhvilluar me votues që sapo kanë fituar të drejtën e votimit (18 deri 19 vjeçar) në Prishtinë.

Kapitujt F dhe G paraqesin figura për pjesëmarrjen e votuesve, të ndara sipas komunave, grupmoshave dhe gjinisë, duke prezentuar të dhënat e mbledhura nga vendvotimet mbi atë se kush ka votuar në katër zgjedhjet e fundit, dhe duke krahasuar ato me të dhënat e ekstraktit të regjistrit civil që përdoret nga KQZ në përgatitjen e listave të votuesve për këto zgjedhje. Të dhënat janë ofruar nga KQZ për secilën komunë, të ndara në gjini dhe për grupmoshat vijuese: të gjithë votuesit, dhe votuesit nga 18 deri në 21; 22 deri në 25; dhe 26 deri në 29 vjeç.

Ka disa çështje të rëndësishme të ndërlidhura me të dhënat e pjesëmarrjes së votuesve. Saktësia e të dhënave nga regjistri civil është vënë në dyshim, posaçërisht në lidhje me heqjen e të vdekurve nga listat e votuesve. Rëndësia e listave të votuesve për pjesëmarrjen e votuesve gjithashtu është vënë në dyshim, pasi që të dhënat e regjistrit civil mbi të cilat bazohet lista e votuesve përfshijnë votues që ndodhen jashtë Kosovës, të cilët mund të mos kenë dëshirë apo mundësi për të marrë pjesë në zgjedhjet e Kosovës. Këta dy faktorë mund të kenë një ndikim në rritje e sipër mbi përqindjet e pjesëmarrjes së votuesve duke u rritur mosha e votuesve. Kjo është një çështje që ngritet tek shumica e vendeve që bazojnë listat e tyre të votuesve në regjistrin civil. Përderisa çështje të tilla duhet t'i kemi parasysh kur shqyrtojmë të dhënat statistikore të paraqitura në këtë raport, përdorimi i të dhënave nga listat e votuesve, me gjithë mangësitë që ka, është standardi ndërkombëtar për llogaritjen e pjesëmarrjes së votuesve. Të dhënat e pjesëmarrjes në këtë raport janë më të saktat që mund të sigurohen aktualisht.

Për komunën e re të Parteshit, e themeluar para zgjedhjeve të vitit 2010, nuk ka të dhëna për zgjedhjet e vitit 2009. Zgjedhjet janë organizuar formalisht në komunat veriore të Kosovës (Zveçan, Leposaviq, Zubin Potok dhe komunën e re të Mitrovicës Veriore), vetëm gjatë viteve 2013 dhe 2014, prandaj pjesëmarrja për disa nga këto komuna ishte e ulët apo zero para vitit 2013. Në zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2010 në komunën e Mitrovicës është përfshirë edhe Mitrovica Veriore, e që mund të ketë ndikuar tek pjesëmarrja e votuesve në Mitrovicë. Së fundi, të dhënat e pjesëmarrjes të paraqitura në këtë raport mund të kenë

mospërputhje të vogla me rezultatet e zgjedhjeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, pasi që, për shembull, në zgjedhjet e përgjithshme nuk përcaktohet numri i fletëvotimeve të dërguara me postë për secilën komunë.

Në këtë raport, zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës i'u referohet si zgjedhje të "përgjithshme", ndërsa zgjedhjeve për kuvende komunale dhe kryetarë të komunave si zgjedhje "lokale".

# D. Gjetjet nga fokus grupet

## 1. Arsyet për të votuar

Shumica e pjesëmarrësve në fokus grupe theksuan se ishin të motivuar për të votuar në zgjedhje. Pjesëmarrësit u përgjigjen me një shumëllojshmëri të arsyeve përse ata apo të tjerët votojnë: për të bërë ndryshime në politikë dhe qeverisje, për të ushtruar detyrën e tyre qytetare dhe obligimin moral, për të siguruar përfitime personale si shpërblim, për t'i penguar të tjerët nga keqpërdorimi i votës së tyre, për ta ushtruar të drejtën e votimit për herë të parë, dhe për të votuar si kundërpërgjigje ndaj presioneve politike dhe shoqërore. Arsyet janë më tutje të shtjelluara në paragrafët vijues.

> *"Nuk është që ndokush shkon të votoj për ndonjë qëllim më të madh apo idealist, përkundër është për ndonjë përfitim personal të zakonshëm, të gjithë ata këtë e bëjnë [votojnë] për ndonjë arsye të ngushtë personale"*
> - Pjesëmarrës mashkull në Graçanicë

Përgjigja më e zakonshme nga pjesëmarrësit në fokus grupe ishte se votimi është një mënyrë për të sjellë ndryshime në politikë dhe qeverisje. Në Vushtrri, shumica e pjesëmarrësve theksuan se ata kishin votuar për të sjellë "ndryshime në politikë", "për ta votuar dikë të ri në politikë", "të shohin ngritjen e subjekteve të reja politike në pushtet", "të largojnë partitë qeverisëse nga pozita e tyre aktuale", dhe "të ndëshkojnë subjektet politike". Pjesëmarrësit në Prishtinë (18 dhe 19 vjeçar) besonin fuqimisht se votimi është një mënyrë për ta ndryshuar partinë udhëheqëse, duke i'u referuar ndryshimeve në Prishtinë pas zgjedhjeve lokale të vitit 2013. Dy meshkuj në grupin e Gjakovës e ndërlidhën votimin me ndryshime në fusha tjera përpos politikës duke theksuar "ndryshimet në arsim, punësim, sektorët e rinisë dhe kulturës" dhe "për zhvillim më të mirë ekonomik".

> *"Votimi më bën të ndihem me vlerë... bëhem pjesë e ndryshimit"*
> - Pjesëmarrëse femër në Prishtina

Një përgjigje tjetër shumë e zakonshme në fokus grupe ishte se votimi është detyrë qytetare dhe obligim moral, qoftë personale apo edhe për shoqërinë. Fokus grupet në Vushtrri, Gjilan dhe Gjakovë vendosën një theks më të veçantë në këtë sesa ato të lokacioneve tjera. Disa e ndërlidhin këtë obligim drejtpërdrejtë me të drejtat qytetare. Pjesëmarrësit tjerë paraqitën një lidhje të fortë në mes aktit të votimit dhe një domosdoshmërie morale për tu kyçur në demokraci. Këto përfshinin një femër në grupin e Gjakovës e cila theksoi se "Për mua, është një obligim moral, kështu që do të mund të marrë pjesë në vendimin lidhur me të ardhmen e vendit tim". Në grupin e Pejës një femër u përgjigj "ky është një vend demokratik, dhe ne si qytetar kemi obligim moral [për të votuar]" kur u pyet përse ajo votoi në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014.

> *"Unë votoj sepse është detyrë qytetare"*
> - Pjesëmarrëse femër në Vushtrri

Në anën tjetër, shpeshherë është cekur përfitimi personal si motivim për votim. Pjesëmarrësit deklaruan se ata votojnë apo do të ishin më të motivuar për të votuar nëse do pranonin ndonjë përfitim të drejtpërdrejtë si shpërblim, kryesisht të ndërlidhura me mundësi punësimi. Dy femra nga fokus grupi i Gjilanit theksuan se mundësitë e punësimit ishin arsyet kryesore përse ato votuan në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014, arsye që jehonte edhe tek fokus grupet tjera, sikur ajo e Mitrovicës Veriore ku një mashkull pohoi se ka votuar në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014 "për arsye punësimi". Një mashkull në fokus grupin e Gjilanit theksoi se do votonte për një kandidat që e njeh personalisht kështu që mund të sigurojë një përfitim të drejtpërdrejtë nga votimi. Në Prishtinë, një mashkull nga grupi tha "Unë pres që anëtari i Kuvendit të më gjejë një vend pune, kështu që të siguroj jetesën". Në përgjithësi, pjesëmarrësit shprehën një qëndrim "çka ka këtu për mua" në lidhje me votimin.

Në disa fokus grupe, pjesëmarrësit ishin të mendimit se nxitje të tilla në baza personale janë burimi kryesor i motivimit për grupet e tjera të votuesve. Pjesëmarrësit në Graçanicë kryesisht u pajtuan se për shumicën e njerëzve votimi është një mënyrë për të siguruar apo rritur ndonjë përfitim personal. Në përgjithësi pjesëmarrësit besonin, jo domosdoshmërisht saktë, se votuesit e moshuar janë më të prirë për të votuar në zgjedhje, kryesisht për shkak se rezultati i zgjedhjeve ndikon tek pensionet e tyre. Sipas pjesëmarrësve në Pejë, punonjësit e administratës publike kanë më shumë gjasa të votojnë në zgjedhje sepse kjo ndikon tek pagat e tyre. Në Gjakovë, një mashkull ishte i mendimit se partitë politike në pushtet ndajnë fonde buxhetore për grupe specifike të votuesve, sikur veteranët e luftës, për t'i nxitur ata për të votuar.

> *"Nuk dua që vota ime të keqpërdoret, edhe nëse nuk ka kandidatë që më pëlqen, unë dal për të votuar dhe e bëjë fletëvotimin të pavlefshëm"*
> \- Pjesëmarrëse femër në Ferizaj

Një përgjigje e shpeshtë nga pjesëmarrësit e fokus grupeve, më e zakonshme në mesin e femrave, ishte se votojnë në mënyrë që dikush tjetër mos të shtiret si ata në Ditën e Zgjedhjeve dhe të keq-përdor emrin e tyre në listën e votuesve. Për shembull, një femër në Gjakovë u përgjigj "unë nuk doja që vota ime të vidhej" kur u pyet përse ajo votoi në zgjedhjet e përgjithshme 2014.

Disa pjesëmarrës të fokus grupeve e rikujtuan entuziazmin e votimit për herë të parë si një arsye përse ata votuan në zgjedhje. Një femër në fokus grupin e Rahovecit dhe një mashkull në fokus grupin e Pejës që të dy theksuan se "ishte hera e parë që votoja", si arsye për votimin në zgjedhjet e përgjithshme 2014. Ngjashëm, një femër në grupin e Ferizajit ishte e entuziazmuar që votoi për herë të parë, dhe theksoi se "më bëri të ndihem më e pjekur". Kjo gjetje përputhet me të dhënat statistikore mbi pjesëmarrjen e votueseve, që tregojnë se rinia e moshës prej 18 deri në 21 vjeç kanë pjesëmarrjen më të lartë në krahasim me grupmoshat tjera.

Në përgjithësi, pjesëmarrësit në fokus grupin e Mitrovicës Veriore ishin të mendimit që votuesve në Mitrovicën Veriore ju bëhet presion të marrin pjesë në zgjedhje nga forca të jashtme. Ata pohuan se kishte presion apo kanosje ndaj njerëzve për të votuar, kryesisht nga partitë politike, por gjithashtu edhe nga familja dhe punëdhënësit. Një femër në fokus grup theksoi se "nënat e reja janë të rrezikuara nga humbja e fondeve të alokuara për fëmijë nëse nuk votojnë në zgjedhje për një parti të caktuar". Disa pjesëmarrës cekën se kompani private

kanë inkurajuar punëtorët e tyre që të votojnë në zgjedhje për një parti të caktuar politike nëse donin ta mbanin punën e tyre.

Përveç këtyre temave të përgjithshme në diskutimet e grupeve të fokusit, pjesëmarrësit dhanë edhe një mori përgjigjesh tjera përse ata votojnë: “në mënyrë që të eliminohet korrupsioni” (femër, Ferizaj); “për shkak të një kandidati” (mashkull, Prishtinë); “sepse më pëlqeu programi politik” (mashkull, Podujevë); “unë votoj sepse është argëtuese” (femër, Gjakovë); dhe “mbështetje për një parti të caktuar” (mashkull, Pejë). Ishte e dukshme se shumë pak pjesëmarrës cekën mbështetjen e tyre për një parti politike, kandidat apo program si arsye për të votuar. Në përgjithësi, shumica dërmuese e pjesëmarrësve në fokus grupe u ndien të motivuar për të votuar, dhe deklaruan se do votonin në zgjedhjet e ardhshme. Ky motivim i përhapur i pjesëmarrësve për të votuar dallon nga statistikat e pjesëmarrjes së votuesve për katër zgjedhjet paraprake, që tregojnë më pak se 50% e rinisë kishte dalë për të votuar.

> *“Unë ndjehem rehat kur votoj për çështje familjare, tema të komunitetit apo parlamentin studentor. Por, ku ka një organizim të madh [zgjedhje], ku shumëçka varet prej saj, dhe disa njerëz janë të gatshëm të ndërmarrin çdo gjë për të fituar, unë pastaj tërhiqem dhe ndihem e distancuar nga pjesëmarrja në zgjedhje të tilla”*
> \- Pjesëmarrëse femër në Mitrovicë Veriore

Në përgjithësi meshkujt dhe femrat në fokus grupe ndanin pikëpamje të ngjashme lidhur me faktorët që i motivojnë për të votuar. Një pikëpamje, që dallonte nga të tjerat, ishte paraqitur nga një femër në fokus grupin e Mitrovicës Veriore e cila shpjegoi se ajo kishte më tepër gjasa të votonte për çështje me nivel rëndësie më të vogël, për të cilat ajo besonte se vota e saj do ketë ndikim më të madh, sikur votimi për çështjet e komunitetit, apo votimi për përfaqësues të parlamentit studentor.

Në përgjithësi, pjesëmarrësit meshkuj dhe femra ishin të mendimit se votimi në zgjedhje lokale dhe të përgjithshme është e rëndësisë së njëjtë. Pjesëmarrësit në përgjithësi theksuan se votimi në zgjedhjet e përgjithshme u jep atyre mundësinë për të ndikuar tek vendimet më të rëndësishme politike të ndërlidhura me të ardhmen e vendit dhe në disa raste cekën se votimi ishte një mënyrë për të ndikuar tek ligjet, buxheti dhe ekonomia.

Kishte një tendencë më të madhe tek pjesëmarrëset femra të pranojnë rëndësinë e zgjedhjeve lokale, ku disa pohuan se votojnë në zgjedhje lokale sepse kjo ndikon tek jeta e tyre e përditshme dhe se ndihen më rehat duke përkrahur kandidatë të cilët i njohin personalisht. Një femër nga grupi i Ferizajt theksoi se “të dyja zgjedhjet janë të rëndësishme, megjithatë, efektet e zgjedhjeve lokale janë më të dukshme”. Një perspektivë tjetër e paraqitur nga një pjesëmarrëse femër në Gjilan është se ajo kishte më tepër gjasa të votonte në zgjedhje lokale sepse “mund t’i njihni njerëzit që janë kandidatë në zgjedhje lokale”. Një femër në grupin e Vushtrrisë theksoi se voton në zgjedhje lokale “sepse [kandidati] është nga fshati ynë dhe duhet të votojmë... ne duhet të shkojmë të votojmë për shkak të kushëririt [kandidatit], dhe kushedi ndoshta do të punësohemi...”.

## 2. Arsyet për të mos votuar

Në përgjithësi, kishte një numër të vogël të pjesëmarrësve në fokus grupe, që theksuan se nuk kishin votuar apo kishin pak gjasa për të votuar në të ardhmen. Sipas pjesëmarrësve, disa prej arsyeve përse ata apo votues tjerë nuk votojnë janë: votimi nuk bën ndonjë

ndryshim, perceptimi i korrupsionit politik, zhgënjimi me proceset politike, perceptimi i mashtrimeve zgjedhore, nuk ka kandidatë apo subjekte politike që duhet përkrahur, zhgënjimi pas votimit për herë të parë, si dhe pengesa teknike posaçërisht tek minoritetet.

Përgjigja më e zakonshme në mesin e pjesëmarrësve lidhur me arsyet e mos votimit ishte se votimi nuk bën ndonjë ndryshim. Një mashkull në grupin e Prishtinës i cili sapo ishte bërë votues ishte i mendimit se vota e tij nuk do të kishte ndonjë ndikim dhe kjo u përsërit nga një person tjetër në fokus grup. Një pjesëmarrëse femër në Gjilan shtoi "... është e njëjtë, sikur të votoja apo mos të votoja". Një pjesëmarrës tjetër mashkull nga Mitrovica Veriore pohoi se nuk kishte votuar në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014 sepse "zëri i popullit nuk dëgjohet".

*"Nuk mendoj se vota ime do ketë ndikim, prandaj jam neutral, nuk mbështes askënd"*
- Pjesëmarrës mashkull në Prishtinë

Disa pjesëmarrës thanë se kanë humbur motivimin për të votuar, kryesisht për shkak të perceptimit të korrupsionit. Një femër në grupin e Rahovecit theksoi se "edhe pse shumica e njerëzve votojnë, gjithmonë do të ketë korrupsion dhe më të mëdhenjtë gjithmonë fitojnë". Një mashkull nga grupi i njëjtë deklaroi se korrupsioni është përhapur çdokund në shoqëri në përgjithësi, dhe votuesit u'a shesin votat e tyre partive politike, ndërsa një tjetër pjesëmarrës mendonte që vota e tij ishte korruptuar për shkak të raportimeve mbi mashtrimet gjatë votimeve në media. Një pjesëmarrëse femër në Gjakovë theksoi se korrupsioni ishte arsyeja kryesore përse ajo nuk kishte votuar në zgjedhjet e mëparshme.

*"Nuk ka parti politike, program... që do ndikoj tek një 18 vjeçar të votoj, sepse ata mendojnë së të gjitha janë hajna"*
- Pjesëmarrës mashkull në Pejë

Disa pjesëmarrës tjerë ishin të dekurajuar për të votuar për shkak të perceptimit të tyre mbi keqpërdorimet në zgjedhje. Në disa fokus grupe pjesëmarrësit veçuan gabimet në listat e votuesve, duke qenë vetë dëshmitar të mashtrimeve, apo duke dëgjuar për mashtrimet në votime në media. Ishte e zakonshme që pjesëmarrësit të theksojnë raste kur ata kishin parë emrat e anëtarëve të vdekur të familjes në listën e votuesve. Një femër në grupin e Rahovecit theksoi "procesi i votimit është gjithmonë i njëjtë, ne kemi vërejtur njerëz të vdekur në listat e votuesve... dhe si votove si nuk votove, vota e jote vidhet". Perceptime të ngjajshme mbi mashtrimet në votime u ndanë edhe nga pjesëmarrësit në Gjakovë.

Kishte gjithashtu pjesëmarrës të cilët ishin të mendimit se nuk kishte subjekt politik apo kandidat që do ta përkrahnin, dhe se nuk ka platforma politike që i trajtojnë si duhet interesat e tyre. Një pjesëmarrëse femër në Ferizaj u përgjigj se "nuk kishte parti që unë do e mbështetja" në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014, ndërsa një tjetër në Rahovec theksoi se "... nuk ka asnjë që i'a vlen për t'a votuar". Një mashkull në grupin e Pejës theksoi "kandidatët nuk po i motivojnë njerëzit e rinj", duke argumentuar mendimin se subjektet politike janë duke dështuar në trajtimin e çështjeve që brengosin rininë, sikur në çështjet e bursave studentore. Duke e hulumtuar arsyen përse ai nuk votoi në zgjedhjet përgjithshme të vitit 2014, një mashkull nga grupi i Mitrovicës theksoi se janë "njerëzit e njëjtë në politikë". Kjo

*"Nuk kishe për kë të votoje [zgjedhjet e përgjithshme 2014], të gjitha janë të njëjtë. Nuk kisha kandidat për cilin do votoja"*
- Pjesëmarrës mashkull në Prishtinë

gjetje përputhet me gjetjet tjera që shumë pak pjesëmarrës theksuan mbështetjen e tyre për një parti politike të caktuar, kandidatë apo politikë si arsye për votimin e tyre.

Kishte një zhgënjim të përgjithshëm tek pjesëmarrësit lidhur me proceset politike dhe institucionet shtetërore në përgjithësi, që duket se i dekurajonte disa pjesëmarrës nga votimi. Një pjesëmarrëse femër nga Ferizaji deklaroi se "premtimet bëhen por nuk mbahen, njerëzit zhgënjehen dhe prandaj nuk votojnë". Një pjesëmarrëse tjetër femër në Skenderaj nuk votoi sepse ajo nuk u beson institucioneve shtetërore, ndërsa një nga Ferizaji ishte e mendimit se njerëzit e rinj nuk votojnë sepse nuk u ofrohet një rol në politikë. Kishte gjithashtu fokus grupe ku rinia pohoi se kishte votuar në të kaluarën, por nuk e marrin parasysh që të votojmë më. Një femër në grupin e Gjilanit theksoi "unë nuk votoi, unë votova njëherë duke shpresuar se diçka më e mirë do bëhej, por vota ime ishte zhgënjim dhe nuk do votoj më më kurrë". Kjo gjetje përputhet me statistikat e pjesëmarrjes së votuesve, të cilat tregojnë se pjesëmarrja ulet në mënyrë progresive në mesin e atyre nga 22 deri në 25, dhe nga 26 deri në 29 vjeç.

> *"Unë votova sa për ta shikuar si shkon, por nuk do votojë më sepse jam e bindur se nuk bënë ndonjë ndryshim, dhe për këtë nuk ka arsye që unë të votoj"*
> - Pjesëmarrëse femër në Rahovec

Në përgjithësi, pjesëmarrësit në fokus grupe nuk u ballafaquan me pengesa teknike të cilat do i dekurajonin apo pengonin ata për të votuar. Megjithatë, disa pjesëmarrës nga minoritetet në Mitrovicën Veriore dhe Graçanicë pohuan se nuk kishin votuar në zgjedhjet e kaluara sepse emrat e tyre nuk ishin përfshirë në listat e votimit. Në Mitrovicën Veriore, disa pjesëmarrës ngritën çështjet e sigurisë në lidhje me votimin, duke përkujtuar dhunën e zgjedhjeve të kaluara. Disa pjesëmarrës u ankuan lidhur me distancën deri në qendrën e tyre të votimit, ndërsa një femër në grupin e Mitrovicës Veriore theksoi se ajo nuk votoi në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014 sepse "nuk isha e informuar".

Kishte edhe disa arsye tjera më pak të shpeshta për të mos votuar të dhëna nga pjesëmarrësit e fokus grupeve. Dy femra në grupin e Rahovecit theksuan se nuk kishin votuar në zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2014 sepse ishin duke punuar në administrimin e zgjedhjeve. Një mashkull nga grupi i Gjilanit theksoi se "rreth kohës së se zgjedhjeve të fundit, disa nga kushërirat e mi të largët më thërrisnin të dilnim dhe më vonë me tregonin për kë të votoj, dhe tani unë më nuk do votoj". Një votues jashtë vendi në Prishtinë theksoi se fletëvotimi i tij arriti tepër vonë nga Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve.

Në përgjithësi, kishte pikëpamje të ngjashme në mes pjesëmarrësve meshkuj dhe femra lidhur me arsyet për të mos votuar në zgjedhje. Disa këndvështrime të tjera janë ofruar nga një pjesëmarrëse femër në Prishtinë, e cila theksoi se "nuk ndihem mjaft e pjekur për ta zgjedhur dikë për katër vitet e ardhshme", dhe një tjetër në Pejë e cila theksoi se femrat në Pejë kanë më pak gjasa të votojnë për shkak të shoqërisë patriarkale në të cilën jetojnë.

